

Dhjetë pyetje të rënda drejtuar Kur'anit E para: Pse ekziston Zoti?

1. Zoti është, Zoti ekziston – parakuptimi më i rëndësishëm i Kur'anit

Nga një lexim i kujdesshëm dhe i gjithanshëm i Kur'anit, qoftë në origjinalin e tij arab, qoftë në përkthim, mësohet se ky Libër ka një pikënisje krejtësisht të veçantë dhe të afërt për të gjithë: ai, disi paraprakisht dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, madje as të ashpër, por me përziemërsi, i propozon njeriut që ta pranojë këtë këshillë: *Beso, o njeri, se Zoti ekziston! Sepse ekzistojnë edhe botët! Prano me zemër të hapur se Zoti është! Sepse janë edhe botët!*

Është e kuptueshme se lexuesit që e pranojnë (ose besojnë) se Zoti *ekziston*, se Zoti *është*, do ta lexojnë Kur'anin më lehtë. Atëherë ky Libër do t'u bëhet më i kuptueshëm dhe më i afërt. Nëse lexuesit shprehin kështu besim ndaj Kur'anit, edhe Kur'ani do të shprehë besim ndaj tyre dhe faqet e tij do të kuptohen më lehtë.

Që Zoti *është*, që Zoti *ekziston* – pikërisht ky është parakuptimi më i fuqishëm i Kur'anit. Fjala hyjnore e Kur'anit, në mënyrë të dukshme, e shmang vërshimin e pyetjeve të drejtpërdrejta si: *A ekziston Zoti? Pse ekziston Zoti? Ose: E, pse Zoti është?* Sikur Kur'ani e këshillon njeriun që t'u largohet këtyre pyetjeve. Natyrisht, jo t'u largohet për shkak se pyetje të tilla do të ishin të ndaluara për njeriun ose sepse ato do ta zvogëlonin "hyjninë/zotësinë e Zotit", por sepse, me madhështinë dhe peshën e tyre, këto pyetje e pengojnë dhe e shfuqizojnë forcën diskursive të njeriut. Për më tepër, pyetje të tilla të rënda – në thelb të panevojshme – i zbulojnë kufijtë realë të aftësive racionale, mendore, kontemplative dhe intuitive të njeriut.

Në të vërtetë, shumë pak nga ajo që mund të mësojmë për Zotin nga Kur'ani ka të bëjë me atë që Ai ishte "përpara" krijimit të botës. Në një mënyrë të tërthortë, njeriu këshillohet që të mos e lodhë mendjen me këtë. Kur'ani nuk është i organizuar si kozmogonitë (greke ose indiane), të cilat do të na flisnin për Zotin në epoka, në kohëra të mëdha ose në periudha kur Zoti ishte vetëm. Dëshira e Fjalës Hyjnore të Kur'anit disi është që ajo menjëherë të na flasë për krijimin gjithëpërfshirës hyjnor, për sundimin, rregullimin dhe veprimin e Zotit në botë, në univers.

Është mirë të dëgjohen vargjet vijuese të Kur'anit, të cilat, të gjitha njëzëri, flasin për krijimin, veprimin dhe ndërhyrjen e Zotit në botë:

"Zoti pastaj [domethënë pas Vendimit të Tij hyjnor], iu kthye krijimit të qiellit, ndërkohë që ai ishte ende tym (mjegullinë, i paformësuar)!" (Fussilet, 41:11)

"Zoti është Ai që i ngriti qiejt që i shihni, pa ndonjë shtyllë..." (er-Ra'd, 13:2)

"Zoti është Ai që krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë periudha (kohore)..." (Junus, 10:3)

"Zoti është drita e qiejve dhe e tokës." (en-Nur, 24:35)

"Zoti është Krijuesi i agimit..." (el-En'am, 6:96)

"Zoti, me të vërtetë, bën që të mbijnë fara dhe bërthama." (el-En'am, 6:95) Dhe kështu me radhë.

Pra, Zoti vepron, dhe pikërisht përmes veprimit Ai tregon se është. Ndërkaq, si është Ai në Vetë-Qenien e Tij dhe në Hyjninë e Tij tërësore – këtë Kur'ani nuk na e shpjegon. Nuk ka asnjë dyshim se, kur Kur'ani flet për Zotin, ai flet për Të kryesisht përmes një shumësie dëshmish: se Zoti i krijon dhe i mban botët, se Zoti manifestohet, se fenomenet e botës dëshmojnë për Të... Dhe pikërisht ky është kuptimi themelor i *vahjit*, domethënë i Revelatës, i Shpalljes, i Zbulesës.

Por Fjala Hyjnore e Kur'anit askund nuk na garanton se Zoti, përmes Vetë-Shpalljes së Tij, do ta zhveshë Vetën nga Fshehtësia e Tij, ose se Fshehtësia e Tij do të zvogëlohet për shkak se Ai i ka krijuar dhe vazhdon t'i krijojë botët! Zoti "edhe më tej" mbetet Njohësi i vetëm i Botës së Dukshme dhe i Botës së Padukshme (*alimu'l-gajbi ve'sh-shehadeh* – et-Teubeh, 9:94), siç thuhet në rreth dhjetë vende në Kur'an. Është domethënëse të vihet re se në këto vende Bota e të Padukshmeve, ose Bota e Padukshme (*el-gajb*), përmendet gjithmonë e para. Sikur vetë Kur'ani, përmes kësaj renditjeje, dëshiron të thotë se me krijimin e botës fenomenale (*esh-shehadeh*), Fshehtësia Hyjnore nuk humb aspak nga pesha dhe vlefshmëria e saj.

Këtu arrijmë te një pohim thelbësor: as në Kur'an Zoti nuk ia zbulon njeriut deri në fund Fshehtësinë e Tij (në arabisht: *kunh, dhat, sirr*). Në katër vende Fjala Hyjnore e Kur'anit (p.sh. el-Ma'ideh, 5:109) shpall qartë se vetë Zoti është "Njohësi i të gjitha Fshehtësive" (*al-lamu'l-gujub*). Dhe pikërisht këtu qëndron aksioma më e madhe e Kur'anit – nëse, sigurisht, është e lejueshme të flitet për aksioma në lidhje me Kur'anin, duke pasur parasysh traditën filozofike të përdorimit të aksiomave si "klithma të kota njerëzore" përballë Gjithëpërfshirësit absolut.

Kur thuhet se Zoti, as në Kur'an, nuk ia ka zbuluar njeriut deri në fund Fshehtësinë e Tij, është e dobishme të kujtohet lutja e zjarrtë e Pejgamberit Musa a.s., e përmendur në suren el-A'raf, 7:143, me të cilën Musai a.s. klithi: *"O Zoti im! M'u shfaq, që të të shoh!"* E përgjigjja Hyjnore, e dhënë me një thirrje madhështore, ishte: *"Ti nuk do të më shohësh!"*

E thënë me fjalët e komentatorëve të njohur sufi, "Qenia Hyjnore" (*dhatullah*), ose, në disa vepra të autorëve sufi, "Thelbi Hyjnor" (*kunhullah*), njihet vetëm nga Zoti, Njeshi, i Vetmi. Njeriu, ndërkaq, këshillohet që Atë, Zotin – qoftë si "Qenie Hyjnore", qoftë si "Thelb Hyjnor" – ta përmendë sa më shpesh dhe sa më shumë, sepse përmendja e Zotit (*dhikrullah*), e përkthyer fjalë për fjalë, është "ajo që është më e madhja, më e larta" (*ve le dhikrullahi ekber* – el-Ankebut, 29:45).

Por nga çfarë është më e madhe dhe më e lartë përmendja e Zotit ose përmendja e Thelbit Hyjnor (*dhikrullah*)? Ashtu si edhe në komentimet klasike të Kur'anit, edhe këtu mund të jepen disa përgjigje. Megjithatë, mund të thuhet se *dhikrullahi* është më i madh dhe më i lartë se sa mendimi spekulativ mbi Thelbin Hyjnor (*tefekkur fi'l-lah*), ndaj të cilit tradita islame ka shprehur rezerva të mëdha.

Në të vërtetë, duhet medituar mbi Botën e Krijimit, por meditimi mbi vetë Zotin e çon mendimin njerëzor në apori (qorrsohak). Zoti, si Mister Absolut (*el-gajbu'l-mutlak*), nuk i zbulohet asgjëje, ndaj as mendimit njerëzor. Por është e këshillueshme të përmendet Zoti (*dhikrullah*) si Mister Absolut, sepse me përmendjen e Zotit "qetësohen zemrat". Siç thuhet në Kur'an, er-Ra'd, 13:28: *"Ta dini se me përmendjen e Zotit qetësohen zemrat."*

Sikur, përmes theksimit të përparësisë së *dhikrullahit* ndaj *tefekkur fi'l-lahit*, Kur'ani – qoftë edhe nga larg dhe vetëm në çaste të shkurtra – na jep mesazhin se shanset e mendimit, të intelektit, të arsyes njerëzore për të depërtuar deri te vetë Thelbi Hyjnor (*dhatullah* ose *kunhullah*) janë jashtëzakonisht të vogla.

Por kjo, në asnjë mënyrë, nuk do të thotë se Kur'ani e nënçmon mendimin, intelektin, arsyen, kontemplimin, intuitën njerëzore... Përkundrazi. Në dhjetëra vende vetë Kur'ani dëshmon se të menduarit e njeriut, mendja, arsyeja, kontemplimi – secila veçmas apo të gjitha së bashku – janë tejet të fuqishme dhe efikase kur bëhet fjalë për pranimin, hulumtimin dhe depërtimin në botët e krijimit Hyjnor (*halkullah*), apo për zhytjen në botët e krijesave Hyjnore (*mahlukatullah*).

Në përgjithësi, tradita islame paraqitet si një nxitje e fuqishme drejtuar njeriut dhe njerëzimit që të mendojnë mbi krijesat e Zotit (*halkullah*, *mahlukatullah*), e jo drejtpërdrejt mbi vetë Zotin.

2. Shmangia nga pyetjet e kota rreth Zotit

"Njerëzit nuk janë të aftë ta gjykojnë (çmojnë) Zotin ashtu si e meriton Ai!" – kjo përsëritet tri herë në Kur'an. Pastaj, me sarkazmin madhështor të Kur'anit, në suren ez-Zumer, 39:67, paraqitet një pamje universale, e frikshme dhe e paimagjinueshme, e pakapshme për mendjen njerëzore: *"Ata nuk e çmuan Allahun me atë madhëstinë që i takon, ndërsa, në Ditën e Kijametit e tërë toka është në grushtin e Tij, e qiejt të mbështjellë në të djathtën e Tij. Ai është i pastër nga të metat dhe Ai është i lartë nga çka ata i shoqërojnë!"*

Me këtë ajet të Kur'anit, sikur njeriut dhe njerëzimit u thuhet: "A mund ta imagjinoni që Zoti e mban tokën në Shuplakën e Tij? A mund ta imagjinoni që të gjithë qiejt janë të palosur nën të Djathtën e Tij? Sigurisht që nuk mundeni. Sepse, më parë, do të duhej ta imagjinonit veten – kaq të vegjël dhe të parëndësishëm siç jeni – diku në fund të kësaj pamjeje të frikshme imaginative. Mundësitë, që prej andej të shihni diçka, janë të barabarta me mundësitë e një kokrrë rëre për ta parë tërë shkretëtirën."

Sipas mesazhit të ajetit 39:67, të qenët e Zotit, ekzistenca e Zotit, e tejkalon arsyen, mendjen, kontemplimin, intuitën njerëzore... Ose, me fjalë të tjera: kur ju, njerëz, nuk i shihni dot të gjithë qiejt, si mund ta shihni Zotin, ose si mund të jeni "të aftë ta gjykoni (çmoni) Zotin në mënyrë të denjë"?

Pamja e frikshme e përmendur më lart për Zotin e Gjithfuqishëm, "i Cili mban qiejt dhe tokën", jepet me qëllim që ta inkurajojë njeriun që të besojë ose të mbështetet në besimin se Zoti *ekziston* dhe se Zoti *është*. Dhe që, në këtë mënyrë, ta kujtojë Zotin, ta përmendë Atë (*dhikrullah*). Ky është kushti kur'anor më themelor, *conditio sine qua non*.

Për më tepër, përmes kësaj pamjeje tronditëse, sikur njeriut i bëhet e qartë se për Fjalën Hyjnore të Kur'anit është krejtësisht e huaj nxitja e njeriut drejt parashtrimit të pyetjeve të shfrenuara dhe mendjemëdha, si p.sh.: "A mos vallë krejt kjo mund të kishte ndodhur edhe pa Zotin?" Ose: "Pse Zoti?" Ose: "A ekziston Zoti në një mënyrë të tillë që dikur Ai të mos ketë qenë?" Ose: "Pse Zoti i Përrjetshëm nuk mbeti i vetëm në Vetminë e Tij dhe përse, në fund të fundit, i duhej ta krijonte universin?"

Duhet thënë menjëherë se pyetje të tilla, ose të ngjashme me to, në Kur'an thjesht nuk ekzistojnë. Edhe pse, në një mënyrë të tërthortë dhe edukative, Kur'ani e këshillon në mënyrë implicite njeriun që t'i anashkalojë këto pyetje, kjo nuk do të thotë se njeriu nuk mund, nuk duhet ose nuk guxon t'i parashtrojë ato. Në të vërtetë, në bazën e të gjitha teorive ateiste, të cilat krijuesit e tyre i konsiderojnë si të menduara në mënyrë koherente dhe të qëndrueshme, gjenden pikërisht këto pyetje të përmendura më sipër.

Megjithatë, edhe pse Fjala Hyjnore e Kur'anit i sugjeron njeriut që të hapet ndaj parakuptimit themelor se e gjithë ekzistenca përmban domosdoshmërisht edhe Dimensionin Hyjnor, sërish Shpallja kur'anore e këshillon njeriun që fuqitë e tij diskursive – arsyen, mendjen, kontemplimin, intuitën... – t'i drejtojë para së gjithash kah krijimi i Zotit, kah krijesat e Tij (*mahlukatullah*), e jo kah vetë Zoti në Qenien e Tij (*dhatullah*) dhe në Thelbin e Tij (*kunhullah*). Këta nxitës të heshtur të Fjalës Hyjnore të Kur'anit, drejtuar njeriut dhe njerëzimit, që të mos parashtrohen pyetje të tilla si: "A mos vallë krejt kjo mund të kishte ndodhur edhe pa Zotin?" Ose: "Pse Zoti?" Ose: "A ekziston Zoti në një mënyrë të tillë që dikur Ai të mos ketë qenë?" Ose: "Pse Zoti i Përjetshëm nuk mbeti i vetëm në Vetminë e Tij dhe përse, në fund të fundit, i duhej ta krijonte Universin?", pikërisht këta nxitës të heshtur për shmangien e pyetjeve mendjemëdha dhe arrogante gjetën vendin e tyre edhe në këshillat, thëniet dhe rekomandimet që Pejgamberi Muhammed s.a.v.s. ua drejtonte shokëve të tij.

Në bisedat me shokët e tij rreth asaj se kah duhet të drejtohen në radhë të parë mendimi, reflektimi dhe aftësitë diskursive të njeriut (*tefekkur*), Pejgamberi Muhammed s.a.v.s. i këshillonte ata që mendjen, arsyen dhe të menduarit t'i orientojnë drejt krijimit Hyjnor (*mahlukatullah*), por jo drejt vetë Zotit, domethënë jo drejt Qenies së Tij (*dhatullah*), as drejt Thelbit të Tij (*kunhullah*). Në të vërtetë, Pejgamberi s.a.v.s. ua jepte shokëve të tij këtë udhëzim: Zoti i Dukshëm (*edh-Dhahir*) përmes krijimit të Tij të përhershëm, është hapësira e vërtetë dhe e denjë për mendimin, arsyetimin, kontemplimin dhe intuitën njerëzore.

Nga thëniet pejgamberike të përcjella shokëve të tij kuptojmë gjithashtu se ai ua përcillte këtë mesazh: ashtu siç tundet e lëkundet mendimi dhe arsyetimi njerëzor përballë Misterit Përfundimtar të Zotit, po aq të paqëndrueshme janë edhe pyetjet e njeriut rreth atij Misteri.

Nuk ka kurrfarë dyshimi se Fjala Hyjnore e Kur'anit ka ndikuar fuqishëm mbi Pejgamberin s.a.v.s., prandaj ai këshillonte që njeriu dhe njerëzimi, para së gjithash, të mendojnë mbi krijesat e Zotit, e jo mbi vetë Zotin. Të menduarit është gjithmonë të menduarit mbi atë që është e pozicionuar, vendore, dimensionale, kohore, relacionale, në një marrëdhënie të caktuar... Sipas Kur'anit, Zoti krijon gjithçka që është e pozicionuar, vendore, dimensionale, kohore, relacionale. Por Zoti nuk e bart Hyjninë e Tij në asnjë nga krijesat e Tij. Pikërisht për këtë arsye, arsyetimi dhe mendimi u shpëton Misteri i Tij Absolut (*el-gajbu'l-mutlak*). Mendimi nuk është në gjendje t'i qaset Zotit si një kërkim i Vetë-Qenies Hyjnore. Ky këshillim orientues, ky amanet kur'anor, gjendet në shumë pasazhe të Kur'anit. Një shembull i tillë gjendet në suren Alu Imran, 3:191: "Ata që e përmendin Zotin duke qëndruar në këmbë, ulur dhe shtrirë në anët e tyre, dhe që meditojnë mbi krijimin e qiejve dhe të tokës, (duke thënë): 'Zoti ynë! Këtë nuk e ke krijuar kot. I Lartësuar qofsh Ti! Na ruaj nga dënimi i Zjarrit!'"

Ky ajet i Kur'anit e inkurajon njeriun që ta përmendë Zotin (*jedhkurunallahe*). Por, njëkohësisht, i këshillon njerëzit që meditimin e tyre (*ve jetefekkeruene*) ta drejtojnë kah krijimi Hyjnor i qiejve dhe i tokës. Me shumë gjasë, jehona e kësaj dhe e thirrjeve të ngjashme kur'anore ishte një nga arsyet kryesore që Pejgamberi Muhammed s.a.v.s., në bisedat e tij me

shokët, t'ua përcillte atyre – dhe përmes tyre brezave të mëvonshëm të muslimanëve – këtë këshillë: *“Meditoni mbi krijesat e Zotit, por mos meditonit mbi Qenien e Zotit, që të mos shkoni drejt shkatërrimit...”*

Ky transmetim pejgamberik gjendet, ndonjëherë, edhe në këtë formulim: *“Meditoni mbi krijimin e Zotit, por mos meditonit mbi vetë Zotin.”* (Krahaso Abdurrauf el-Munavi, *Fajdu'l-Kadir, Sherhu'l-Xhami'is-Sagir*, Kajro 1937)

3. Fshehtësia Absolute si përmallim i njeriut

Le ta përmbyllim këtë artikull duke kujtuar se, në traditën fetare islame, e më pas edhe në kulturën dhe civilizimin islam, janë shkruar shumë trajtesa dhe reflektime mbi mallin e njeriut për të depërtuar deri te Fshehtësia Absolute.

Në të vërtetë, që “Zoti ekziston” ose që “Zoti është” – kjo përbën një nga parakuptimet më themelore, për të cilat Kur’ani, në mënyrën e vet të veçantë (dhe të pashprehur drejtpërdrejt), “kërkon” një *pajtim paraprak* të pashpjegueshëm, si nga njeriu ashtu edhe – siç thonë disa komentime të Kur’anit – nga qenie të tjera mendore, rationale dhe kontemplative (melekë/engjëj, xhinë, shejtanë, ifritë...).

Sikur nga Kur’ani, nga çdo fletë e tij, rrezaton një aromë e përgjithshme shpirtërore, e cila mund të shndërrohet në këtë pyetje: “A është vallë e mundur të shtrohet pyetja nëse Zoti ekziston?” Sipas Kur’anit, një pyetje e tillë do të ishte mendjemadhe, thjesht sepse ajo parashtrohet nga hapësira të pafundme të botës së krijuar. Pikërisht botët e krijuara (*el-avalim*) janë garancia se Zoti ekziston, por edhe fusha kryesore mbi të cilën duhet menduar, mbi fillimin e së cilës duhet kontempluar – e jo, siç e thamë më herët, mbi pyetje të tilla si: “A ekziston Zoti?” ose “Pse ekziston Zoti?” Në një farë mënyre, gjithçka që u tha deri më tani, tregon se vetë Kur’ani parakupton një “metodologji të leximit të drejtë të Mesazhit të këtij Libri”.

Sigurisht, të gjitha këto pyetje të rënda – si p.sh. “A ekziston Zoti?” ose “Pse ekziston Zoti?” – edhe pse Kur’ani nuk i përmend shprehimisht, nënkuptohen vetëm për t’i treguar përmasat e pamatshme dhe të paarritshme nga fuqitë njerëzore të krijimit Hyjnor: universin, botët e dukshme dhe të padukshme, natyrën, florën, faunën, njeriun... Pikërisht për këtë arsye, për t’i shmangur vështirësitë e pyetjeve “A ekziston Zoti?” ose “Pse ekziston Zoti?”, Kur’ani e rikthen njeriun dhe qeniet e tjera mendore që të merren me botët – të dukshme dhe të padukshme – dhe të pyesin: “Nga vijnë këto botë?”, “A mund të kenë lindur vetvetiu?”, “Pse është e pamundshme që ato të jenë bashkë të përjetshme me Zotin?”

Për më tepër, veçanërisht e rëndësishme është se në dhjetëra vende të Kur’anit shpallet në mënyrë të rreptë dhe solemne se Zoti është vetëm Një (*la ilahe il-la Hu, vahid*), se nuk ka hyjni përveç Tij. Të supozohet se krahas Zotit ekzistojnë hyjni të tjera është krejtësisht në kundërshtim me logjikën e vetë “të qenit Zot”, sepse në natyrën e Hyjnisë qëndron domosdoshmërisht njësi absolute. Dy, tre apo më shumë gjithëfuqi hyjnore universi nuk do të mund t’i përballonte, por do të shembej dhe do të shkatërrohej. Sikur nga këto përkujtime kur’anore shfaqet një ironi e heshtur, e drejtuar kundër atyre që mendojnë se në univers mund të ekzistojnë shumë hyjni.

Me shumë gjasë, këtu qëndrojnë edhe arsyt pse Pejgamberi Muhammed s.a.v.s., në bisedat e tij me shokët, ua përcillte këtë këshillë: *“Meditoni mbi krijesat e Zotit, por mos meditoni mbi Qenien e Zotit, që të mos shkoni drejt shkatërrimit...”*

Meditimi mbi botët si krijesa Hyjnore e çon njeriun drejt besimit në Zotin, i Cili Njëjësinë e Tij e ruan për Vete, por që, kur krijon, krijon shumësinë.

Le të kujtojmë, krejt në fund, një traktat të Ibni Arabiut mbi Vetminë Hyjnore (*er-Risale el-Ehadije*), ku Ibn Arabiu guxon të kontemplojë dhe të teozofizojë mbi Qenien Hyjnore (*dhatullah*). Madje, ai guxon të flasë edhe për atë se “si Zoti, në vetminë dhe fshehtësinë e Tij, nga një dashuri e madhe dëshiroi t’i krijojë botët, dhe vërtet i krijoi ato.”

Kuntu kenzen mahfijjen fe ahbebtu en u’rafe fe halektu’lhalka - “Isha një thesar i fshehur; desha të njihem, prandaj i krijova krijesat.”

Me këtë, natyrisht, ky gjigant i mendimit islam guxoi ta lexojë Kur’anin në një mënyrë të tillë që *dhikrullahi*, ose kujtesa e Zotit, t’i shërbejë si mjet për t’u përkulur mbi gjendje dhe epoka para krijimit të botëve. A është e mundur që njeriu të shohë edhe përtej atyre horizonteve – kjo është një pyetje për të cilën mund të diskutohet, me kusht që të mos harrohen botët e panumërta të krijuara.

Në tërësi, dija e njeriut është e brishtë. Ajeti madhështor Ajetu’l-Kursij (el-Bekara, 2:255) shpall: *“Asgjë nga dija e Tij nuk mund të përvetësojnë (njerëzit), pos sa të dojë Ai.”*

Mund të thuhet se e njëjta gjë vlen edhe për botën dhe universin: njerëzit dinë për botën dhe universin vetëm aq sa Zoti dëshiron. Këtu arrijmë te dija Hyjnore si një mjet i mundshëm me të cilin njeriu mund ta njohë botën. Por çështja nëse njeriu mund të marrë një pjesë të dijes Hyjnore si dhuratë, apo nëse mund ta fitojë atë, duhet të jetë temë e një artikulli të veçantë.

Burimi: *Preporod*, nr. 1/1204, 15 janar 2022, f. 10-11.

Nga gjuha boshnjake: Rehan Neziri